2559/27
20.11.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 8615/1 Prot. Tiranë, më 18/11/2026

Lënda: Kthim përgjigje mbi "Rregulloren për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike".

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)
Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 2559/12 Prot., datë 21.10.2026 "Ftesë për konsultim dhe paraqitje komentesh mbi *"Rregulloren për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike*", protokolluar në MIE me Nr. 8615 Prot., datë 23.10.2026, për të cilin ERE ka filluar procedurën me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 288, datë 08.10.2026, ju bëjmë me dije si vijon:

Neni 4 "Ofertat që publikohen në Platformën e Krahasimi të Çmimit" i projekt-rregullores, përcakton kategoritë e ofertave të furnizimit me energji elektrike që përfshihen në platformë, kriteret e publikimit të tyre, si dhe detyrimin për informimin e përdoruesve në rastet kur platforma nuk mbulon të gjithë tregun ose kategori të caktuara ofertash.

Sa më sipër, vlerësojmë se formulimi i këtyre dispozitave të rregullores duhet të garantojë përmbushjen e detyrimit ligjor për mbulimin e të gjithë tregut sikurse përcaktohet në pikën 1 të nenit 100 të ligjit Nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike". Në rast se ERE vlerëson se kufizimi i parashikuar në këto dispozita diktohet nga arsye objektive, ato duhet të argumentohen dhe të shoqërohen me një parashikim për arritjen progresive të mbulimit të plotë të tregut në përputhje me nenin 100 të ligjit. Po kështu, sugjerojmë përcaktimin e kategorive sipas pikës 1 të këtij neni, kjo duke mbajtur në konsideratë vendimmarrjet e mëparshme të Bordit të ERE-s sipas vendimit Nr. 241/2024, i ndryshuar me vendimin Nr. 43/2025.

Në zbatim të nenit 100, pika 3, të ligjit Nr. 59/2026, sjellim në vëmendje se, furnizuesit kanë detyrimin të informojnë klientët mbi disponueshmërinë dhe mënyrën e aksesimit të mjetit të krahasimit, nëpërmjet faturave të furnizimit me energji elektrike dhe publikimit të këtij informacioni në faqet e tyre të internetit. Në këtë kuadër, sugjerojmë që ERE, në ushtrimin e përgjegjësive të saj për administrimin dhe funksionimin e platformës, të marrë në konsideratë këtë detyrim ligjor, me qëllim lehtësimin e aksesit të klientëve në mjetin e krahasimit dhe sigurimin e informimit të tyre nga furnizuesit.

Lidhur me nenin 13 "Konsumi vjetor i përdoruesit", për pikën 1, shkronjën "c", dhe pikën 3, sugjerojmë rishikimin/unifikimin e formulimit të këtyre dispozitave, pasi të dyja parashikojnë përdorimin e profileve standarde të konsumit në mungesë të të dhënave për përcaktimin e konsumit vjetor, duke krijuar mbivendosje në përmbajtje dhe paqartësi në zbatimin e tyre.

Lidhur me nenin 16 "Parimet për standardet informatike" duke qenë se në përmbajtje të këtij neni referohen vetëm standarde në terma të përgjithshëm sugjerojmë identifikimin e tyre.

Lidhur me nenin 22 "Siguria", sugjerojmë që pika 1 të përcaktojë qartë referencën ndaj legjislacionit në fuqi dhe të garantojë përputhshmërinë me të.
Ndërkohë, lidhur me nenin 25 "Administrimi i Platformës së Krahasimit të Çmimeve", konstatojmë se pika 1 e tij përsërit parashikimin e pikës 1.1 të projekt-rregullores. Për këtë arsye, sugjerojmë rishikimin e kësaj dispozite, me qëllim shmangien e përsëritjeve dhe përmirësimin e teknikës legjislative.

Për sa i përket nenit 27 "Verifikimi i informacionit përpara publikimit", pika 1, vlerësojmë se kjo dispozitë krijon mbivendosje me detyrimin e përcaktuar në nenin 26, pika 2, për sa i përket përcjelljes së informacionit nga furnizuesit përpara publikimit të ofertës. Për këtë arsye, sugjerojmë rishikimin e formulimit të pikës 1, me qëllim dallimin e qartë të detyrimit për transmetimin e informacionit nga procesi i verifikimit të tij përpara publikimit.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besjan Kadiu